

KËSHILLI I NDERIT pranë Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, **SHGM**, duke vepruar sipas parashtresave të Ana Çupeskës nga Shkupi, profesoreshë në Fakultetin Juridik në USHKM, kundër gazetarëve të IRL Sashka Cvetkovska dhe Ivana Nasteska për përmbajtje nga komunikimi verbal, komente në rrjetin social FB nga profilet personale, në mbledhjen e radhës së Këshillit të mbajtur më 02.11.2023 solli këtë

VENDIM

REFUZOHEN PARASHTRESA E ANA ÇUPESKAS NGA SHKUP KUNDËR SASHKA CVETKOVSKAS DHE IVANA NASTESKAS SEPSE NUK BËHET FJALË PËR PRODUKT, TEKST GAZETARESK POR KOMENTE NË PROFIL PERSONAL FEJSBUKU.

Arsyetimi

Ana Çupeska nga Shkupi, duke u prezantuar si profesoreshë në Fakultetin Juridik në USHKM - Shkup, ka dorëzuar dy parashtresa në Këshillin e Nderit, kundër, siç thuhet në parashtresë, gazetarëve të IRL-së, Sashka Cvetkovska dhe Ivana Nasteska, për komentet e shkruara në postimin e saj në profilin e Fejsbukut, në profilin e saj apo profilet e tyre, të shkaktuara nga statusi për gjrobat dhe shuma në pjesën e amnistisë së planifikuar.

Çupeska pohon se gazetarët në vend që të raportnin për pikëpamjet e saj, i shtrembëruan mendimet e saj në FB dhe në këtë mënyrë inkurajuan: bullizim, mizogjini, gjuhë të urrejtjes, dëmtim të imazhit, imazhit të saj dhe të Universitetit, në vend se të raportnin për opinionin e treguar, i cili ishte i ndryshëm nga persona të tjerë në sferën e juridikut.

Bashkangjitur ka dorëzuar kopje të komenteve në FB.

Këshilli i Nderit konstatoi se nuk bëhej fjalë për ndonjë informacion apo produkt gazetaresk nga gazetarët e IRL-së, të cilët në këtë rast veprojnë nga profilet e tyre personale, siç është edhe profili i Çupeskës, dhe për këtë arsye i hodhi poshtë ankesat në tërësi si të pabazuara. Duke vënë në dukje se bëhet fjalë për profile në rrjetin social FB, për të cilin vlejnë rregullat e komentimit, dhe nëse përmbajnë fyerje apo gjuhë urrejtjeje, mund të raportohen tek administratorët e rrjetit social.

Parashtruesja në mënyrë kategorike dhe të pabazë përfshin familjen e saj dhe Universitetin në parashtresë, edhe pse në asnjë kontekst nuk mund të lidhet me to mendimi i saj i shprehur në FB, dhe as

komentet në lidhje me qëndrimin e saj nuk mund të nënkuptojnë cenimin e integritetit të Universitetit. Poashtu, si profesoreshë, situatë që nuk paraqitet në këtë rast, duke qenë se shkrimi i saj nuk është pjesë e një diskutimi shkencor apo profesional, as një vepër e autorit, e botuar në një medium të përshtatshëm, parashtruesja duhet të jetë e vetëdijshme për peshën e fjalës së deklaruar në publik, dhe duhet të jetë tolerante dhe të pranojë kritika dhe opinione të ndryshme, siç ka shpërndarë edhe vetë mendime për gazetarët në komentet në profilet e tjera në FB.

Në të gjitha situatat e tjera, parashtruesja e ka mundësinë që ta rregullojë privatësinë e përmbajtjes së profilit, kështu që ajo ka mundësinë të vendosë vetë me kë do të ndajë pikëpamjet dhe opinionet.

Për këto arsye, Këshilli i Nderit i hodhi ankesat poshtë në tërësi, pasi është jo kompetent për të vendosur për “zënka” në komentet e FB.

Këshilli i Nderit pranë SHGM-së vazhdon të rikujtojë se gazetarët janë të obliguar të kultivojnë kulturën e të folurit në komunikimin publik, ku përfshihen edhe rrjetet sociale, por nga dëshmitë e siguruar kjo nuk ka ndikuar në një vendim tjetër.

Këshilli i Nderit, si pjesë e vetërregullimit në media, rikujton se është kompetent të vlerësojë produktet mediatike, e jo pikëpamjet personale të gazetarëve, për të cilat ka një rregullim tjetër ligjor nëse dalin jashtë normave të përcaktuara.

Njëkohësisht u bën thirrje parashtruesve të ardhshëm të këtij lloji të parashtrësve që të bëjnë dallimin se çfarë është informacioni, mediumi, komenti në rrjetet sociale apo mendimi i shprehur në mënyrë tjetër, që është kategori kushtetuese e lirisë së shprehjes.

Vendosur në Shkup më 02.11.2023

Të publikohet në faqen e internetit të SHGM-së

KËSHILLI I NDERIT NË ZNM

President

Sashe Dimovski

